

RIKUJTIM- APLIKIMI PËR BURSË NË HUNGARI (Stipendium Hungaricum)

Informata për aplikim

Konkursin e gjeni në webfaqen e MASHTIT- kontrollo konkurset (shiko te gjitha dokumentet që janë për bursë të Hungarisë te publikuara që nga muaji Nëntor 2022:

Lexo me kujdes tek konkurset dokumentin - Hungari General Information 2020-2023

<https://masht.rks-gov.net/general-information-about-the-stipendium-hungaricum-program-mou-2020-2023-2/>

Verifikimi i dokumentete bëhet në zyren NARIC, kati përdhësë.

Kandidatët që aplikojnë për nivelin Bachelor dhe OTM duhet të verifikojnë:

Për ata që ende nuk kanë diplomuar: Dëftesa e klasës: X dhe XI

Të diplomuarit: diploma e shkollës së mesme dhe dëftesat e notave

Kandidatët që aplikojnë për nivelin Master dhe apo PhD duhet të verifikojnë:

Diploma dhe transkripta e notave e studimeve paraprake

Për çdo dokument që ju mungon, vendos deklaratë personale të nënshkruar dhe arsyen dhe se do ta sjellni.

Shembull: ju mungon deftesa e kl.XII , diploma dhe matura, certifikata e mjekut, etj..vendos për çdo dokument të munguar deklaratë se ju mungon dhe se do ta sjellni në afatin e kërkuar me konkurs.

Kjo vlen edhe për studentët që aplikojnë në nivelet tjera Master apo PhD që të vendosin deklaratat për dokumentet që nuk kanë arritur t'i marrin dhe arsyen.

Në aplikimin online ngarko dokumentin origjinal të lëshuar nga Shkolla apo Universiteti, varësisht se në cilin nivel aplikoni. Dokumentit origjinal i bashkangjet përkthimin zyrtar të të njejtit dokument. Nëse shkolla apo Universiteti ju lëshon dokumentin origjinal p.sh dëftesat, transkriptat apo diploma edhe në gjuhë angleze, nuk keni nevojë të bëni përkthim tjetër.

Kontrollo dokumentet për ngarkim:

CV, Motivimi, rekomandimet nga profesorët, letërpranimin nga Universiteti në Hungari apo të mentorit nëse keni arritur ta merrni paraprakisht nga Universiteti në Hungari, dëftesat/ transkriptat, diploma (vula e Ministrisë e verifikimit e vendosur nga zyra NARIC i bashkangjitet si foto), certifikata e gjuhës angleze sipas konkursit, projektpropozimi apo plani i hulumtimit (nëse është duke u kërkuar nga ndonjë program specifik varësisht nga Universiteti apo niveli i studimit) . Ngarko portofolion nëse ke zgjedhur fushë studimi ku është kërkuar vendosja e portofolios nga Universiteti dhe poashtu me konkurs. Vendos dokumentet origjinale dhe përkthimet zyrtare. Vendos deklaratë personale të nënshkruar për dokumentet e munguara, arsyen e mungesës dhe se do ta sjellni në afat. Lexo rregullat apo thirrjen zyrtare të Stipendiumit dhe kontrollo webfaqet e vendosura në thirrje sepse ofrohen informata të shumta dhe duhet ti lexoni për të evituar gabimet në aplikim dhe fazat e tjera.

Një shembull vetëm si formë për deklaratë personale sa për të kuptuar që përmbajtja ka të bëjë me deklaram por edhe zotim se do ti ngarkoni në afat nëse nominoheni:

Deklaroj që në këtë aplikim më mungon:

Diploma e shkolles së mesme;

Dëftesa e kl XII;

Certifikata e mjekut;

Xxxx (varësisht qfarë ju mungon, cekë dokumentin)

Arsyea: Diploma dhe dëftesa lëshohen afërsisht gjatë gjatë muajit xxxx 2023.

Sipas thirrjes Stipendium, certifikata e mjekut do të kërkohej nëse nominohem deri me dt...

Deklaroj që pas marrjes se dokumenteve nga institucioni do ti vendosi në afatin e kërkuar sipas Stipendium Hungaricum.

Data:

Emri dhe mbimeri - nënshkrimi (personal i aplikuesit)

Aplikimi dhe ngarkimi i dokumenteve:

Aplikimi është vetëm online në linkun e Stipendium Hungaricum (shih konkursin e cekur më lartë)